

VENDIM
Nr. 346, datë 7.6.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIM URBAN I AMBIENTEVE REKREATIVE, RESTAURIMI I
FASADAVE TË OBJEKTEVE, NË LAGJEN ‘5 SHTATORI’, ÇOROVODË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i ambienteve rekreative, restaurimi i fasadave të objekteve, në lagjen ‘5 Shtatori’, Çorovodë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhen këtij vendimi, për pasuritë e llojit “garazh”, “apartament” dhe “njësi”, me një vlerë të përgjithshme prej 4 223 038 (katër milionë e dyqind e njëzet e tre mijë e tridhjetë e tetë) lekësh.

4. Masa e shpërblimit për pronarët, që shpronësohen, është 4 223 038 (katër milionë e dyqind e njëzet e tre mijë e tridhjetë e tetë) lekë dhe përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar.

5. Vlera e shpenzimeve të procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Skrapar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhen këtij vendimi kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Skrapar.

8. Bashkia Skrapar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Skrapar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Skrapar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Skrapar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Skrapar, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Skrapar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Skrapar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Skrapar dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM URBAN I AMBIENTEVE REKREATIVE, RESTAURIMI I FASADAVE TË OBJEKTEVE, NË LAGJEN ‘5 SHTATORI’ ÇOROVODË”

Nr	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNI ME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	TRUALL			NDËRTESE			Vlera totale (lekë)	
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
	a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	q	r	s=q*r	t	u	v	z	
1	Eqerem	Kambe r	Ajasllari	Çorovod ë	1420	13/76	Garazh	26			26				1,015	0	26	9,806	254,960	254,960	Konfirmuar nga ASHK-ja. Pronari sipas ASHK Eqerem Ajasllari, ndërsa sipas dok. të identifikimit Myqerem Ajasllari. është i njëjti person.
2	Tomorr	Neshat	Bregu	Çorovod ë	1420	13/78	Garazh	32			32				1,015	0	32	9,106	291,377	291,377	Konfirmuar nga ASHK-ja.
3	Kastriot	Dilvaer	Kushova	Çorovod ë	1420	13/30	Garazh	20			20				1,015	0	20	8,519	170,384	170,384	Konfirmuar nga ASHK-ja.
4	Haziz	Sherif	Çeço	Çorovod ë	1420	13/72	Garazh	70			70				1,015	0	70	9,705	679,354	679,354	Konfirmuar nga ASHK-ja. Pronari sipas ASHK Haziz Çeço, ndërsa sipas dok. të identifikimit Haziz Çeçaj, është i njëjti person.
5	Ali	Nesim	Hasanago	Çorovod ë	1420	13/20	Njësi	203		203	40	8	92	203	1,015	206,045	40	9,122	364,879	570,924	Konfirmuar nga ASHK-ja. Pronari sipas ASHK Ali Nesim Hasanago, ndërsa sipas dok. të identifikimit Aleksandër Nesim Shani. është i njëjti person.
6	Fatri	Hekura n	Nuellari	Çorovod ë	1420	13/77	Njësi	32		32	32	8	91	32	1,015	32,480	32	7,914	253,232	285,712	Konfirmuar nga ASHK-ja. Kufizimet ne seksionin

																					E: U vendos barrë hipotekore me shkresën 3772/1 dt.22.06.201 7
7	1. Agim 2. Sonila	Fiqiri Xhelal	Ibro Ibro	Çorovod ë	142 0	13/71	Garazh	15			15	8	99		1,015	0	15	12,014	180,209	180,209	Konfirmuar nga ASHK- ja.
8	Nexhmij e	Musa	Memollari	Çorovod ë	142 0	13/27-N1	Njësi	36			36	8	13 1		1,015	0	36	4,173	150,237	150,237	Konfirmuar nga ASHK- ja. Pronari sipas ASHK-së Nexhmije Musa Memollari, ndërsa sipas dok. të identifikimit Naxhije Musa Memollari, është i njëjti person.
9	Fatbardh a	Qazim	Liço	Çorovod ë	142 0	13/27-N2	Njësi	27			27	8	13 2		1,015	0	27	5,289	142,816	142,816	Konfirmuar nga ASHK- ja. Pronari sipas ASHK Fatbardha Qazim Liço, ndërsa sipas dok. të identifikimit Fatbardha Qazim Kovaçi. është i njëjti person. Kovaçi mbiemri pas martesës.
10	1.Adriati k 2.Tatjana	Skënder Nesim	Murati Murati	Çorovod ë	142 0	13/27+1- 1	Apartame nt	42			42	2	19 4		1,015	0	42	13,260	556,900	556,900	Konfirmuar nga ASHK- ja. Sipas ASHK pronarët kanë mbiemrin Murati, ndërsa sipas dok. Të identifikimit , mbiemri i pronarëve është Murataj. Janë të njëjtët persona.
11	Sokol	Selam	Hoxha	Çorovod ë	142 0	13/27+2- 2	Apartame nt	42			42	2	19 4		1,015	0	42	13,226	555,501	555,501	Konfirmuar nga ASHK- ja.

12	1. Gramos 2. Tefta	Qazim Sefer	Alimeri Alimeri	Çorovod ë	142 0	13/27+3- 3	Apartame nt	42			42	2	19 6		1,015	0	42	6,716	282,092	282,092	Konfirmuar nga ASHK- ja. Kufizimet ne seksionin E: Nuk ka hartuar aktin e privatizimit. Pronarë të këtij objekti do jenë. Gramos Qazim Alimeri dhe Tefta Sefer Alimeri.
13	Tahir	Turhan	Myftari	Çorovod ë	142 0	13/273	Garazh	9			9	8	10 4		1,015	0	9	11,397	102,572	102,572	Konfirmuar nga ASHK- ja.
	SHUMA													235		238,525	433		3,984,513	4,223,038	